



# **Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri**

**Raporti i Vlerësimit Institucional të IAL-së:  
Universiteti “Nehemia Gateway”  
Prill 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- |    |               |         |
|----|---------------|---------|
| 1. | Kevin Kendall | Kryetar |
| 2. | Neil Casey    | Anëtar  |
| 3. | Ana Kapaj     | Anëtare |

**Data: Prill 2017**

## **Përmbajtja**

Rreth këtij Vlerësimi .....	1
Konteksti i këtij vlerësimi .....	2
Raporti i përmbledhur.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	4
Raporti i detajuar.....	6
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij .....	6
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet .....	10
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula .....	14
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	18
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre .....	21

## Rreth këtij Vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që hyn në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është një proces i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që janë të specializuar në të njëjtën fushë, dhe çdo grup vlerësimi përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe të mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar nën pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre, duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur.**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht.**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht.**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka siguruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, duke siguruar që grupi t'i mbështesë konstatimet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

## Konteksti i këtij vlerësimi

Institucioni jo publik i arsimit të lartë “Nehemia Gateway” është një institucion privat, që ndodhet në qytetin e Pogradecit, në Juglindje të Shqipërisë. Ky IAL është pjesë e rrjetit botëror të Grupit “Nehemia Gateway”, me seli në Nuremberg, Gjermani. Vendndodhja e institucionit është zgjedhur, për t’i ndihmuar njerëzit që të rindërtojnë jetët e tyre, nëpërmjet të nxënimit me në qendër studentin dhe mësimdhënien cilësore, dhe për t’i ndihmuar shqiptarët të krijojnë lidhje me komunitetet evropiane dhe botërore. Institucioni financohet nga Fondacioni “Nehemia Gateway, Shqipëri”, i cili vepron në Shqipëri që prej vitit 1922. Fillimisht, Fondacioni u përqendrua tek shkollat fillore dhe të mesme të Shqipërisë, por që prej vitit 2005, ka ofruar mundësi për studentët që të ndjekin arsimin e lartë, me anë të këtij institucioni.

Misioni i institucionit është: “Të ndihmojmë dhe fuqizojmë njerëzit që në mënyrë të qëndrueshme të formojnë dhe përcaktojnë jetët e tyre me dinjitet dhe pavarësi”.

Institucioni ka katër objektiva kryesore:

- 1 Mbështetja e studentëve që dëshirojnë të ndjekin arsimin e lartë.
- 2 Krijimi i mundësive që studentët të bëhen udhëheqës të përgjegjshëm, mendimtarë dhe bashkëpunues, dhe ekspertë me iniciativë.
- 3 Lehtësimi i procesit arsimor, nëpërmjet programeve dinamike dhe cilësore.
- 4 Bashkëpunimi në projekte të veprimtarisë kërkimore me institucione të tjera.

Institucioni ka dy fakultete: Fakultetin e Biznesit dhe Teknologjisë dhe Fakultetin e Shkencave Humane. Çdo fakultet ka një departament: Departamenti i Biznesit dhe Ekonomisë ofron programin e nivelit Bachelor në Ekonomi dhe Biznes, ndërsa Departamenti i Edukimit dhe Etikës ofron programin e nivelit Master e Shkencave në Leadership dhe Vlerësim Arsimor.

Institucioni është pjesë e Fondacionit “Nehemia Gateway”, dhe një pjesë e shërbimeve administrative ofrohen nga vetë Fondacioni, si për shembull, burimet njerëzore, menaxhimi financiar, marketingu, biblioteka, shërbimet e IT-së, menaxhimi i godinës dhe çështjet ligjore.

Aktualisht, institucioni ofron vetëm dy programe të arsimit të lartë, programin e nivelit Bachelor në Ekonomi dhe Biznes dhe programin e nivelit Master në Leadership dhe Vlerësim Arsimor, megjithëse institucioni planifikon të ofrojë më shumë programe në të ardhmen e afërt.

Në programin e nivelit Bachelor, në të tre vitet, janë të regjistruar 56 studentë, ndërsa në vitin e dytë të programit të Masterit janë të regjistruar 11 studentë. Nga këta 67 studentë, shtatë janë nga Uganda, tre nga Sudani Jugor, dy nga Tanzania, dy nga Kuba, një nga Meksika dhe një nga Gjermania, ndërsa të tjerët janë shqiptarë.

Numri i stafit të Institucionit është 23, prej të cilëve shtatë janë staf akademik me kohë të plotë. Nga 23 persona të punësuar, nëntë janë me shtetësi të huaj. Institucioni ka një numër të madh pedagogësh me kohë të pjesshme.

Institucioni ka një kampus universitar në Pogradec, që përfshin auditorët, dhe ambientet mbështetëse për stafin dhe studentët. Ambientet përfshijnë auditorë leksionesh dhe seminaresh, bibliotekë, salla kompjuterike, ambiente sportive, një qendër mjekësore dhe një restorant.

## Raporti i përmbledhur

Raporti i Vetëvlerësimit u hartua nga një ekip brenda institucionit, që përbëhej nga: titullari i institucionit; zëvendës titullari i institucionit; drejtuesi i Menaxhimit të Cilësisë; dhe një përfaqësues i studentëve. Projekt raportet iu dërguan një audience të gjerë brenda institucionit, para se ato të finalizoheshin dhe të miratoheshin nga Presidenti dhe nga grupi i hartimit të Raportit të Vetëvlerësimit. Institucioni bashkëpunoi plotësisht gjatë procesit të vlerësimit, dokumentacioni u vu në dispozicion në anglisht dhe, sipas kërkesës, u vu në dispozicion edhe dokumentacioni shtesë.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i vlerësimit u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe mbajtësi i shënimeve, të siguruar nga APAAL, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, shtatë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas me dokumentet shtesë të kërkuara. Gjithsej, u morën në konsideratë 80 dokumente, të cilat e ndihmuan grupin e vlerësimit të njihet me strukturën, politikën dhe procedurat e menaxhimit, dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Dokumentet që u shqyrtuan përfshinin: Statutin e institucionit; rregulloret akademike; raportet vjetore; vlerësime dhe shqyrtime financiare; udhëzues; procesverbale të mbledhjeve; procedurat e pranimit dhe orientimit; gamën e marrëveshjeve të jashtme; shembuj të informacioneve për programet; dhe procesverbale nga mbledhjet vendimmarrëse.

Gjatë tre ditëve të vizitës së vlerësimit, u organizuan një sërë mbledhjesh, që i mundësuan grupit të vlerësimit të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi i vlerësimit u takua me Presidentin, Drejtorin Ekzekutiv, Titullarin e institucionit, Zëvendës Titullarin e institucionit, drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, pedagogët dhe personelin administrativ e mbështetës. Gjatë mbledhjeve u mbajtën shënime. Gjatë turit në kampusin e universitetit, grupi i vlerësimit vizitoi bibliotekën, auditorët dhe sallat e TI-së. Grupi i vlerësimit, pasi shqyrtoi evidencat e vëna në dispozicion, arriti në përfundimet që parashtrihen në vijim.

Institucioni i përmbush plotësisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Ai e ka bërë publik Statutin, i cili shpreh qartësisht rregulloret për funksionimin dhe menaxhimin e institucionit në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, dhe ishte elementi mbi të cilin u mbështet dhënia e licencës nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Grupi i vlerësimit gjykoj se organizimi udhëhiqet nga vlera të mëdha, që kanë ndikim pozitiv te përvoja e studentëve, dhe institucioni është i përkushtuar ndaj mobilitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, si për stafin, ashtu edhe për studentët.

Ndërmarrja e studimeve të tregut për sa i përket mundësisë së punësimit, për të kuptuar më mirë tregun vendas është një aspekt tjetër i praktikës së mirë. Grupi i vlerësimit nuk identifikoi ndonjë dobësi dhe nuk bëri rekomandime për këtë Fushë Vlerësimi. Grupi i vlerësimit pohoi ecurinë e institucionit, për të përparuar me kërkesat e ligjit të ri për arsimin e lartë.

Institucioni i përmbush plotësisht standardet për Burimet. Përgjegjësitë për buxhetin dhe burimet, janë të parashikuara në Statut. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi aspekte të praktikës së mirë të institucionit, në lidhje me stafin e kualifikuar ndërkombëtar, që iu ofrojnë studentëve përvoja të reja të të nxënimit. Grupi i vlerësimit nuk identifikoi ndonjë dobësi dhe nuk dha rekomandime në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi. Grupi i vlerësimit pohoi veprimet e institucionit, për të digjitalizuar sistemin e ruajtjes së të dhënave të studentëve.

Institucioni i përmbush plotësisht standardet për Kurrikulat. Dy programet e ofruar të studimit, janë plotësisht të harmonizuar me Misionin dhe Vizionin e gjerë të Grupit “Nehemia Gateway” për vitin 2020, që thekson se është një organizatë ndërkombëtare e ndihmës, duke pasur arsimin si një ndër katër “shtyllat” mbështetëse. Grupi i vlerësimit identifikoi tipare të praktikës së mirë në programet e dyfishta të institucionit, që ndërthurin teorinë me praktikën, për të promovuar punësimin, dhe në hapat e ndryshme që janë ndërmarrë për të shënuar arritje në mobilitetin e studentëve në Evropë dhe përtej saj.

Institucioni i përmbush plotësisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Institucioni ka mekanizma të përshtatshme në dispozicion, për të siguruar organizimin dhe dokumentimin e efektshëm të programeve të studimit. Grupi i vlerësimit evidentoi tipare të praktikës së mirë në lidhje me mundësitë për zhvillimin e stazhit dhe ofrimit të mbështetjes gjatë këtij procesi, si edhe në shumëllojshmërinë e njerëzve pranë institucionit, me studentë shqiptarë dhe të huaj, staf akademik dhe personel mbështetës. Grupi i vlerësimit konstatoi mungesën e një politike kërkimi dhe nivelin e ulët të kërkimit institucional, përfshirë edhe mungesën e ofrimit të një programi doktorature, duke i konsideruar si dobësi të institucionit, dhe rekomandon që institucioni duhet të rrisë përqendrimin tek kërkimi shkencor, si edhe të zhvillojë dhe të zbatojë politikën e tij të kërkimit. Grupi i vlerësimit nuk pohoi veprime që po ndërmerren në fushën e vlerësimit të Mësimdhënies, Mësimnxënies, Vlerësimit dhe Kërkimit.

Institucioni përmbush plotësisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Përgjegjësitë për studentët dhe mbështetja për ta, janë të parashikuara qartësisht në Statutin e institucionit. Grupi i vlerësimit evidentoi tre fusha të praktikës së mirë. Së pari, të gjitha kurset ofrohen në gjuhën angleze dhe shumica e tyre zhvillohen nga pedagogë të huaj; së dyti, institucioni ofron mundësi punësimi për studentët e diplomuar; dhe, së fundmi, programet e dyfishta të studimit dhe trajnimi teorik dhe praktik, nëpërmjet stazheve që i ofrohen studentëve, i ndihmon ata të përvetësojnë aftësi dhe zotësi, të cilat do iu shërbejnë për punësimin e tyre në të ardhmen, siç u përmend më sipër. Grupi i vlerësimit nuk evidentoi dobësi dhe nuk bëri rekomandime ose pohime, në lidhje me këtë Fushë vlerësimi.

## Përmbledhje e gjetjeve

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë.

- organizimi i institucionit udhëhiqet nga vlera të rëndësishme, që kanë ndikim pozitiv te përvoja e studentëve (pika 1.2; **Kapitulli III Standardi I.1**)
- studimi i tregut të punës, që institucioni e ka kryer për të kuptuar më mirë nevojat që ka tregu vendas i punësimit (pika 1.13; **Kapitulli III Standardi III.1**)
- përkushtimi i institucionit ndaj mobilitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, si për stafin, ashtu edhe për studentët (pika 1.13; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- disponueshmëria dhe përkushtimi i stafit ndërkombëtar të kualifikuar, që zgjerojnë përvojën e të nxëniet të studentëve (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.1**)
- programet e dyfishta të institucionit, që integrojnë teorinë me praktikën, për të nxitur punësueshmërinë (pika 3.8 dhe 5.9; **Kapitulli I Standardi I.11, Kapitulli I Standardi III.9**)
- hapat e ndryshëm të ndërmarrë për të mundësuar mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe përtej Evropës (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.10**)
- institucioni iu ofron studentëve shumë mundësi për stazh dhe i mbështetet ata gjatë këtij procesi (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1**)

- shumëllojshmëria e shtetësive, me studentë shqiptarë dhe të huaj, staf akademik dhe mbështetës, si shqiptar, ashtu edhe të huaj. (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.3**)
- të gjitha kurset ofron në gjuhën angleze dhe disa prej kurseve zhvillohen nga lektorë ndërkombëtarë (pika 5.6; **Kapitulli I Standardi III.6**)
- Institucion ofron vende pune për studentët e diplomuar të tij (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

## Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Nuk ka politikë për kërkimin dhe ka një nivel të ulët të kërkimeve institucionale, përfshirë mungesën e një programi doktorature. (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.2**).

## Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Institucioni duhet të shtojë përqendrimin te kërkimi shkencor dhe të zhvillojë e të zbatojë politikën e tij të kërkimit (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.2**).

## Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se aktualisht po ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Përshtatja e politikave me kërkesat e ligjit të ri për arsimin e lartë (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi I.1**)
- Veprimi i institucionit për të digjitalizuar sistemin e ruajtjes së të dhënave të studentëve (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VIII.1**).

## Gjykime përmbljedhëse për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet e Organizimit dhe Menaxhimit, janë përmbushur **plotësisht**.
- 2 Standardet e Burimeve janë përmbushur **plotësisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë përmbushur **plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin, janë përmbushur **kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre, janë përmbushur **plotësisht**.

## Gjykimi i përmbljedhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e “Nehemia Gateway”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht.



## Raporti i detajuar

### Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Institucioni e ka publikuar Statutin **[A6]** që shpreh qartësisht rregulloret për funksionimin dhe administrimin e institucionit në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë”, dhe mbi këtë element u bazua dhënia e licencës **[A5]** nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Përmbajtja e Statutit **[A6]** përfshin detaje mbi Misionin, Objektivat, Strukturën, Financimin dhe Auditimin e institucionit. Stafit **[M1; M2; M3; M6]** dhe studentët **[M4]** janë njohur me të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e parashtruara në Statut, dhe drejtuesit e institucionit **[M2; M3]** janë të vetëdijshëm për nevojën për t'i përshtatur ato sipas dispozitave të Ligjit të ri “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ndaj zhvillimit të kërkesave të institucionit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** ecurinë e shënuar nga institucioni, gjatë përpjekjes për të përshtatur politikën me kërkesat e Ligjit të ri “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Struktura e re e propozuar parashikon funksionimin e tij si një Akademi me Bord Drejtues, Senat Akademik dhe një fakultet, dhe institucioni është i gatshëm ta zbatojë këtë, kur të jetë e nevojshme. Drejtori Ekzekutiv do të bëhet administratori dhe titullari i institucionit, Rektori **[A1; M2; M3]**.
- 1.2 Nehemia vepron në bazë të vlerave, filozofisë dhe parimeve të Grupit Nehemia Gateway **[M2; A1]**, dhe misioni i saj është: “Të ndihmojmë dhe fuqizojmë njerëzit që në mënyrë të qëndrueshme të formojnë dhe përcaktojnë jetët e tyre me dinjitet dhe pavarësi.” Objektivat e institucionit pasqyrojnë këtë mision dhe grupit të vlerësimit, nëpërmjet diskutimeve me stafin **[M2; M3; M5]**, studentët **[M4]**, të diplomuarit dhe punëdhënësit **[M5]** u bë e qartë se ky mision ndiqet dhe kuptohet gjatë gjithë organizimit, për shembull, nëpërmjet zbatimit të objektivave, me anë të veprimtarive strategjike dhe operacionale. Ky është një institucion që udhëhiqet nga vlera të rëndësishme, që kanë ndikim pozitiv te përvoja e studentëve, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e gjykon këtë si një tipar të **praktikës së mirë**.
- 1.3 Institucioni qeveriset nga Bordi Mbikëqyrjes (Bordi i Drejtorëve), dhe ka shpallur termat e referencës **[A8]**. Institucioni ka një komision dhe strukturë të qartë raportimi **[B2; B1]** që janë të publikuara në faqen e tij të internetit [<http://www.ng-university.org/our-university/about/organizational-chart.html>]. Bordi i Mbikëqyrjes emëron Bordin Këshillues, i cili është përgjegjës për dhënien e këshillave akademike dhe etike, veçanërisht në lidhje me strategjinë e institucionit. **[A1; A6]**. Titullari i institucionit emërohet nga Bordi Këshillues **[A1; A6]** dhe mbështetet nga Grupi i Drejtimit të Nivelit të Lartë, që është organi ekzekutiv i institucionit. Grupi i Drejtimit të Nivelit të Lartë përbëhet nga Titullari i institucionit, Dekanët e fakulteteve, Drejtori Ekzekutiv, Drejtori i Marketingut dhe Drejtori i Axyhendës së Kërkimit Shkencor.
- 1.4 Aktualisht, institucioni ka dy fakultete dhe dy departamente, që ofrojnë udhëheqje akademike për programin e Bachelorit në Ekonomi dhe Biznes dhe programin e Masterit i Shkencave në Leadership dhe Vlerësim Arsimor. Aktualisht, institucioni përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë **[B2]**. Në zhvillim e sipër, institucioni planifikon të shtojë edhe tre fakultete **[A1; A6]**. Ka edhe dy funksione akademike administrative, konkretisht Zyra e Provimeve dhe Zyra e Menaxhimit të Cilësisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
- 1.5 Institucioni ka dorëzuar një plan të ri për strukturën, për t'u miratuar nga Ministria **[A1]**, në përputhje me Ligjin e ri “Për Arsimin e Lartë”, dhe është në pritje të një përgjigje **[A1; M2]**. Rrjedhimisht, institucioni dhe strukturat e tij, funksionojnë në përputhje me Statutin aktual dhe janë të gatshme t'iu përgjigjen kërkesave të reja, kur është e nevojshme.

- 1.6 Komisionet e institucionit mblidhen rregullisht sipas një kalendari mbledhjesh **[B7]** dhe i kanë të përcaktuara përgjegjësitë dhe temat për diskutim. Janë mbajtur procesverbale, gjë që tregon se i përmbushin detyrat e tyre në mënyrë të efektshme **[A7; A9; A16; A17; A18; A19; A22; B8; B11]**
- 1.7 Menaxhimi financiar i institucionit, duke përfshirë caktimin dhe monitorimin e buxhetit, vendoset në mbledhjet për financën, **[A9]** ku ka përfaqësim nga drejtuesit e nivelit të lartë në Institucion dhe bazohen në propozimet nga fakultetet **[A1; M6]**. Buxhetet vendosen me bazë vjetore dhe monitorohen vazhdimisht, duke i dërguar **çdo muaj** një Pasqyrë Financiare grupit mëmë **[M6]**. Mbledhjet për financën zhvillohen katër herë në vit dhe raportet e përgatitura, të cilat publikohen, rishikohen dhe auditohen çdo vit **[M6; A23; A27]**.
- 1.8 Stafi vlerësohet dhe promovohet në bazë të Planit të Vlerësimit të institucionit **[A11; M3]**, sipas një Formulari Vlerësimi të VPP-së **[A12]**. Zhvillohen takime individuale midis stafit dhe Drejtorit Ekzekutiv, ku vlerësohet performanca kundrejt objektivit **[M6]**.
- 1.9 Institucioni nuk ka një Bord të veçantë për Etikën, por duke qenë se është institucion me përmasa të vogla, këto përgjegjësi i ngarkohen Bordit të fakultetit **[A1]**. Bordet përbëhen nga Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Departamentit dhe përfaqësues të studentëve **[A1]**.
- 1.10 Përveç organeve të përmendur më sipër, institucioni ka edhe komisione të tjera, si Komisioni i Planifikimit Strategjik **[A19]** dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë **[B6]**, ku janë anëtarë shumë pjesëtarë të stafit **[M6]**. Axhenda e takimeve shpallet paraprakisht, nxitet zhvillimi i debateve gjatë takimeve, dhe procesverbalet, ku regjistrohen vendimet e marra, publikohen më vonë **[A1; A7; A9; A16; A17; A18; A19; A22; B8; B11]**.
- 1.11 Organizimi i institucionit bën dallim midis funksioneve akademike dhe atyre administrative **[B1; B2]**. Ndonëse këto mund të jenë të ndërlidhura në nivele të larta, në nivel fakulteti, përkushtimi ndaj çështjeve akademike, lidhur me administrimin e programeve dhe ofrimit të mundësive për stafin që të ndjekë kërkimin akademik, është i dukshëm **[A1; M3; M6]**.
- 1.12 Strategjia e zhvillimit të institucionit është në përputhje me *Vizionin 2020* **[A24]** të Grupit Nehemia. Plani Strategjik i institucionit **[A10]**, Vlerësimi Vjetor i Planit Strategjik **[A25]** dhe Vlerësimi i Objektivave të institucionit **[A26]**, janë të kuptueshme nga stafi **[M1; M2; M3; M6]**. Vlerat e institucionit përfshijnë: faljen, respektin, integritetin, ndershmërinë, dhembshurinë dhe përkushtimin, dhe këto vlera janë pjesë të pandashme të misioneve dhe objektivave të institucionit. Objektivat shërbejnë për t'i mbështetur studentët që duan të ndjekin arsimin e lartë, për t'i ndihmuar ata të bëhen udhëheqës dhe ekspertë të përgjegjshëm, mendimtarë dhe bashkëpunues, që tregojnë iniciativë për projekte kërkimore në institucione të tjera. Institucioni publikon Raportin Vjetor në lidhje me veprimtaritë e tij, të cilin ia dërgon Ministrisë, dhe e vendos në dispozicion të stafit në faqen e internetit <http://www.nehemiah-gateway.al/en/information/media-al.html>, **[B9]**.
- 1.13 Raport i Vetëvlerësimit **[A1]** parashtrohet se qëllimi kryesor i institucionit është zhvillimi i rajonit, nëpërmjet njohjes së studentëve me praktikën dhe përvojat ndërkombëtare të biznesit. Raporti më pas tregon se ambicia e themeluesve të institucionit është kontributi në zhvillimin socio-ekonomik të pjesës shqiptare të Liqenit të Ohrit, me anë të programeve të ofruara. Institucioni ka kryer studime tregu për mundësitë e punësimit, në mënyrë që të kuptohen më mirë nevojat e rajonit, dhe i ka i zhvilluar programet e tij të studimit bazuar në këto nevoja, që është një tregues

tjetër i **praktikës së mirë**. Detaji i shqyrtuar i jep institucionit siguri në synimet dhe objektivat e programeve të ofruara. **[A53]**. Institucioni bashkëpunon me partnerë në rang vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar **[A1; A34; A35; A39; C5]**, dhe kjo pasqyrohet edhe në diversitetin e shtetësisë së studentëve, që studiojnë në këtë institucion **[A2; M4; M5]**. Institucioni, gjithashtu, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe jashtë vendit **[A32]**, përfshirë shumë nga Gjermania, ku edhe është themeluar Grupi Nehemia. Për më tepër, institucioni ka vendosur lidhje me Amerikën e Jugut dhe me Afrikën **[M5]**, ku janë punësuar disa të diplomuar, siç u diskutua në takimin me alumni, partnerë dhe punëdhënës **[M5]**. Përbërja e pedagogëve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme, është ndërkombëtare **[A2]**, me 70 për qind të lektorëve të ftuar që vijnë nga vende të tjera **[A33]**. Për ta përmbledhur, institucioni tregon qartësisht përkushtim ndaj mobilitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, si për stafin **[M2; M3]**, ashtu edhe për studentët **[M4; M5]** dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm të jashtëm e konsideron këtë si tregues të **praktikës së mirë**.

- 1.14 Institucioni po zhvillon një lidhje ndërvepruese me Universitetin e Korçës në Shqipëri **[M5]**. Marrëveshja u nënshkrua në vitin 2017 dhe përfshin veprimtari të tilla si shkëmbime të studentëve dhe stafit dhe plane për një program të përbashkët Master **[M5]**.
- 1.15 Institucioni mbledh të dhëna statistikore për pranimin, shtetësinë, mbajtjen, suksesin dhe punësimin e studentëve, dhe ato janë të publikuara sipas programit, pra si për programet e ciklit të parë dhe për programet e ciklit të dytë, në faqen e internetit të institucionit [<http://www.ng-university.org/our-university/about/facts-figures.html>]. Megjithëse numri i studentëve është i ulët, përqindja e punësimit është e lartë. Institucioni kryen gjithashtu studime të tregut për mundësitë e punësimit për studentët e diplomuar **[A53]**. Si rrjedhojë, gjykimet e bëra nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, në bazë të dokumenteve të mësipërme, janë se standardet e Fushës së Vlerësimit 1 në lidhje me autonominë, organizimin dhe partneritetin, janë përmbushur plotësisht.

## Gjetje

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë.

- organizimi i institucionit udhëhiqet nga vlera të rëndësishme, që kanë ndikim pozitiv te përvoja e studentëve (pika 1.2; **Kapitulli III Standardi I.1**)
- institucioni ka kryer studime të tregut në lidhje me punësimin, për të kuptuar më mirë nevojat që ka rajoni (pika 1.13; **Kapitulli III Standardi III.1**)
- përkushtimi i institucionit ndaj mobilitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, si për stafin, ashtu edhe për studentët (pika 1.13; **Kapitulli III Standardi III.4**).

### Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Ecuria për të përparuar me kërkesat e ligjit të ri për arsimin e lartë (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi I.1**).

## Gjykimi

**Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Përgjegjësia për buxhetin dhe burimet parashikohet në Statutin e institucionit [A6]. Struktura organizative e institucionit është e pasqyruar në Manualin e Fakultetit dhe në faqen e internetit [A1 fq. 23; <http://www.ng-university.org/our-university/about/organizational-chart.html>]. Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv i institucionit, por përgjithësisht, administrimi i burimeve njerëzore i transferohet degës shqiptare të Nehemia Gateway [A1 fq. 23; A2; A3; A33; A10; C2, pjesa 8]. Vendet e lira të punës sipas kriterëve të përcaktuara shpallen në faqen e internetit të Grupit Nehemia Gateway [<http://www.nehemiah-gateway.al/en/career/job-vacancies.html>; A34; C2, pjesa 8]. Të gjithë të emëruarve iu sigurohet një kontratë standarde sipas politikave të Grupit Nehemia Gateway. Përshkrimet e punës, për të gjitha pozicionet, janë të publikuara në Manualin e Fakultetit [10; RVV fq. 26-29; CV e stafit akademik dhe dosjet e kontratës, që u vunë në dispozicion gjatë vizitës]. Politika e promovimit të institucionit është e pasqyruar në Manualin e Fakultetit [C2; A10; A33].
- 2.2 Megjithëse institucioni ka 24 persona në stafin akademik dhe profesional me kohë të plotë, ai mbështetet edhe te pedagogët me kohë të pjesshme dhe lektorë të ftuar nga Shqipëria dhe nga vende të tjera [A32; M1; M2; M3]. Pas caktimit, lektorëve të ftuar iu jepen orientime dhe më pas qëndrojnë në institucion për një periudhë 2-3 javore; shpeshherë ata vijnë disa herë gjatë një viti akademik. Pas largimit të tyre, ata janë të disponueshëm nëpërmjet emaileve. [CV-të e stafit akademik dhe dosjet e kontratave u vunë në dispozicion gjatë vizitës ; M3]. Stafi i Burimeve Njerëzore gjen zëvendësuesit, në rast se për ndonjë arsye të caktuar lektori i ftuar nuk mund të jetë i pranishëm [M3; M6]. Studentët janë mirënjohës për cilësinë dhe disponueshmërinë e stafit akademik dhe për përcjelljen e përvojës ndërkombëtare [M4] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron disponueshmërinë dhe përkushtimin e stafit ndërkombëtar të kualifikuar, që pasuron përvojën e të nxëniet të studentëve, si një karakteristikë të praktikës së mirë.
- 2.3 Informacioni i institucionit dhe, më gjerë, i Grupit të Nehemia Gateway, bëhet publik në mbledhjet e rregullta, që zhvillon institucioni, në faqen e internetit të institucionit dhe nëpërmjet manualëve përkatës, përfshirë edhe Manualin gjithëpërfshirës të Politikave [A10; A11; A12; A13; C2]. Drejtuesit e institucioneve shpjeguan se nxitja e një ndjesie komunitare për lektorët e ftuar, të cilët mund të jenë vizitorë rastësorë, përbën prioritet [M3]. Stafi akademik dhe profesional mbështetës, që u takua me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, ishte i njohur me misionin e institucionit dhe Fondacionit [M4; M6].
- 2.4 Institucioni ndjek një politikë për vlerësimin e stafit, si për stafin akademik, ashtu edhe për atë administrativ, me synime të caktuara kundrejt objektivave të fakultetit dhe përshkrimet e pozicioneve të punës [Dosjet e stafit të shqyrtuara gjatë vizitës]. Stafi me përvojë vlerësohet nga Bordi Mbikëqyrës, i cili vlerëson edhe performancën e vet [A7; A8; A9; A10; A37]. Drejtori i Menaxhimit të Cilësisë analizon të dhënat, që i dorëzohen organeve të fakultetit [A36; A37]. Stafi, përfshirë derjtuesit, iu nënshtrua vlerësimit dhe të gjithë evidentuan rezultate pozitive [M3; M5; M6; Dosjet e stafit të gjatë vizitës].
- 2.5 Stafi është i njohur me tiparet dalluese dhe qëllimet e institucionit, dhe, më gjerë, të Fondacionit Nehemia Gateway. Kjo përforcohet më tej nga stafi që banon në kampusin me shumë struktura, ku ka shkolla dhe institucione mjekësore. Për të promovuar integrimin, organizohen një sërë aktivitetesh dhe konferencash shoqërore, si dhe takime formale [A35; M1; M2; M3; M5; Turi i kampusit; C3; M6].

- 2.6 Në përputhje me misionin e tij të përgjithshëm, institucioni financohet kryesisht nga donacionet dhe grantet, por një pjesë e vogël e të ardhurave vijnë edhe nga tarifat shkollore të studentëve. Pjesa më e madhe e studentëve mbështetet nga programi i Bursave për Trajnim dhe Edukim me Perspektivë (STEP) të Grupit Nehemia **[A1 fq. 30; M1; M4; M6; B9; C2, Seksioni 8]**. Institucioni ndjek politikën financiare dhe qasjen ndaj menaxhimit financiar të Grupit Nehemia Gateway. Megjithatë, ai e harton vetë buxhetin vjetor, që duhet të përputhet me objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik të Nehemia Gateway. **[A6; C2, Seksioni 8]**. Buxheti caktohet në bazë të propozimeve të fakultetit, të përcaktuara nga Grupi i Drejtuesve të Lartë, miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes dhe të rishikohet në Mbledhjet mujore për Financat. Mbikëqyrja realizohet nga Titullari i institucionit dhe nga Drejtori Ekzekutiv **[A3; A14; A52; A53; A40; A41; A5; C2, Seksioni 8; M6]**.
- 2.7 Pasqyrat financiare janë subjekt i auditit të jashtëm, që në kohët e fundit ka përfshirë edhe një shqyrtim shtesë financiar nga një konsulent i jashtëm. Bordit të Mbikëqyrjes i vihen në dispozicion të gjitha raportet e auditit **[A23; A19; A3; A14]**. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vunë në dispozicion raportet financiare të audituara, dhe një kopje e raportit më të fundit, të dorëzuar në Ministri. Raporte më të plota vjetore ishin publikuar në faqen e internetit të institucionit, deri në vitin 2012. Institucioni synon të rivendosë raportin vjetor dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nxitë ta realizojë këtë ambicie **[B9; <http://www.nehemiah-gateway.al/en/information/media-al.html>; C9; M2]**.
- 2.8 Institucioni përdor sistemin e informacionit të Grupit Nehemia. Ka faqe interneti funksionale, intranet dhe sistem të postës elektronike. Institucioni ka kompjuterët e vet, por shumica e studentëve kanë laptopët e vet **[C2; M4; [www.ng-university.org](http://www.ng-university.org); Turi i kampusit]**. Politikat dhe informacione të tjera, përfshirë të dhënat për rekrutimin dhe mbajtjen në institucion të studentëve, janë të përfshirë në dokumente si Statuti, Manuali i Fakultetit dhe Manuali i Politikave, të cilët janë të publikuar në faqen e internetit **[A2; A7; A10; C2; <http://www.ng-university.org/our-university/about/facts-figures.html>]**. Studentët janë mirënjohës për sistemin e informacionit të institucionit, për të cilin ata marrin orientim të efektshëm **[RVV fq. 35; A42; M4]**.
- 2.9 Institucioni ndodhet jashtë Pogradecit, në një zonë të vogël të saponjërtuar, në pronësi të Nehemia Gateway. Kampusi është shumë funksional, ka një shkollë, një qendër shëndetësore, ambiente sportive, dhe një shtëpi miqsh (ku akomodohen lektorët e ftuar), si dhe godinat e institucionit **[Turi i kampusit; A43]**. Ekipi i strukturave administron pronën dhe asetet e tjera, në përputhje me Planin e Vlerësimit. Ka një Komisionin e Strukturave dhe Teknologjisë së Informacionit, por ai nuk zhvillon rregullisht mbledhje, dhe mbikëqyrja operationale normalisht bëhet nga Grupi i Drejtimit të Nivelit të Lartë **[A7; C2, Seksioni 10; M6]**. Politikat e Grupit Nehemia Gateway përcaktojnë vlerësimin e institucionit dhe zhvillimin e pronës akademike, kulturore dhe shkencore **[C2, Seksioni 7]**. Puna e institucionit mbështetet nga një grup administratorësh që u ofrojnë mbështetje studentëve dhe stafit **[Turi i kampusit; M4; M6]**.
- 2.10 Auditorët dhe ambientet e tjera arsimore, janë të vendosura në disa ndërtesa, që të gjitha moderne, të ndëruara me dritë natyrore dhe të mirëpajisura. Projektimi fillestar i ndërtesës siguroi që të përmbusheshin normat statutores **[A43; RVV fq. 37; M6; Turi i kampusit]**. Biblioteka ndodhet në një dhomë të vogël, ku ka rreth 10.000 libra në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, por ka akses edhe në një sërë burimesh në internet. Megjithatë, drejtuesit e institucionit, studentët, stafi akademik dhe alumni, pranojnë të gjithë se strukturat bibliotekare duhet të përmirësohen, sidomos nëse rritet numri i studentëve **[RVV fq. 39; 43; Anketimi i stafit, fq. 10;**

**Anketimi i Studentëve; M4; M5; M2].**

- 2.11 Informacion mbi programet e studimit gjendet në Statut, në Katalogun dhe Manualet e Fakultetit [A2; A10; A29]. Të dhënat e studimeve janë aktualisht të shtypura [Dosjet e studentëve u vunë në dispozicion gjatë vizitës; Regjistri]. Një bazë të dhënash të besueshme për rekrutimin dhe arritjet e studentëve është në ndërtim e sipër, por institucioni pranon se kjo duhet të përmirësohet [M6]. Për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje, institucioni po shqyrton dy sisteme të të dhënave tregtare, por në kohën e vizitës nuk kishte marrë një vendim zyrtar se cilin do të zbatonte dhe kur do të fillonte zbatimin [M6]. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e institucionit, për të digjitalizuar sistemin e të regjistrimit të të dhënave të studentëve.

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë.

- disponueshmëria dhe përkushtimi i stafit ndërkombëtar të kualifikuar, që zgjerojnë përvojën e të nxënit të studentëve (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.1**).

### **Dobësi**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

### **Pohim i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- Veprimi i institucionit për të digjitalizuar sistemin e ruajtjes së të dhënave të studentëve (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VIII.1**).

## **Gjykimi**

**Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.**



## Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Institucioni ofron dy programe studimi, programin e nivelit Bachelor në Ekonomi dhe Biznes dhe programin e nivelit Master i Shkencave në Leadership dhe Vlerësim Arsimit. Të dy programet përputhen me Misionin dhe, më gjerë, me Vizionin 2020 të Grupit Nehemia Gateway, që thekson se ajo është një organizatë ndërkombëtare e ndihmës, që ka arsimin një ndër katër “shtyllat” e saj themelore. Grupi nxjerr në pah orientimin e tij në tregun e punës dhe nevojat e grupeve sociale të marginalizuara, dhe e konsideron arsimin si një mjet kyç për arritjen e këtij qëllimi **[A20; A2; Fletëpalosjet e programit; RVV fq. 40; C3; C4]**.
- 3.2 Kurset që ofron institucioni janë “programe të dyfishta”, që synojnë të integrojnë teorinë me praktikën, nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë profesionalë në ndërmarrje, organizata joqeveritare dhe administratën publike. Të gjithë studentët duhet të zhvillojnë praktikën profesionale, si dhe të ndërmarrin veprimtari teorike **[M1; Fletëpalosjet e programit; fq. sh., <http://www.ng-university.org/study-programs/ba-economy-businesses.html>]**. Ka shumë mundësi aplikimi në programe të ndryshme, dhe studentët mund të aplikojnë për module të veçanta, në përputhje me një angazhim institucional për të mësuarit, gjatë gjithë jetës **[M1; Fletëpalosjet e programit; RVV fq. 43]**.
- 3.3 Në përputhje me Planin Strategjik, si institucioni ashtu edhe Grupi Nehemia Gateway, aspirojnë t'i zhvillojnë më tej programet e studimit. Megjithatë, është gjerësisht e pranuar se zhvillimi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe kjo parashikohet të arrihet nëpërmjet zhvillimit të programeve modulare, që nxisin fleksibilitetin me më pak investime, dhe të nxënit e përzier **[A6; M1; M2; M3; C3; C4]**. Ka një Komision për Kurrikulën, i cili vepron si një grup pune që organizon mbledhje dhe funksionon sipas kërkesës së Komisionit të Sigurimit të Cilësisë. Megjithatë, ai ende nuk ka organizuar ndonjë mbledhje, ndërsa vendimet për kurrikulën janë marrë nga organet e nivelit të lartë **[A7; M3; M1]**.
- 3.4 Të dy programet e institucionit janë akredituar nga agjencitë e huaja, nga Fondacioni për Akreditimin e Administratës Ndërkombëtare të Biznesit (FIBAA), nga Gjermania, dhe nga Shoqata Ndër Kombëtare e Kolegjeve dhe Shkollave të Krishtera (TRACs), nga SHBA-ja. Programi i nivelit Bachelor u akreditua sërish nga FIBAA në vitin 2015, pa kushte **[A51; Fletëpalosjet e programit; M1; M3; A1 fq. 50; A48]**. Për më tepër, janë nënshkruar marrëveshje me institucionet e tjera të arsimit të lartë në Gjermani, SHBA dhe Shqipëri **[A28]**. Rreth njëzetë për qind e stafit akademik vijnë nga vende të tjera dhe studentët kanë ardhur nga Afrika dhe Amerika Latine, si dhe nga vendet evropiane **[M4; M6; Profilet e stafit u vunë në dispozicion gjatë vizitës]**. Programet e studimit organizohen në anglisht **[Fletëpalosjet e programit; A24; A29]**.
- 3.5 Objektivat e institucionit janë paraqitur në dokumentacionin e institucionit, duke përfshirë Katalogun dhe Manualin e Fakultetit **[A10; A29]**. Gjithashtu, objektivat e programit janë të përcaktuara qartë në Katalog, ku gjenden përshkrime të moduleve bashkë me qëllimet, përmbajtjen, rezultatet mësimore dhe kërkesat për vlerësim. Kreditet llogariten në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) **[A29; A45]**.
- 3.6 Kurrikula dhe rezultatet e të nxënit në programin e nivelit Bachelor në Ekonomi dhe Biznes mbulojnë nga çështjet e përgjithshmet si dhe ato specifike. Modulet mbulojnë kërkesat themelore, duke përfshirë metodat e kërkimit dhe aftësitë akademike **[A24; A29; A45; RVV fq. 41-43; Fletëpalosjet e programit]**. Realizimi i ngarkesës mësimore organizohet në mënyrë të tillë që kur disa grupe zhvillojnë orë teorike,

grupe të tjera bëjnë trajnime praktike.

- 3.7 Zhvillimi i programit të nivelit Master në Leadership dhe Vlerësim Arsimor përmbush nismën e Qeverisë Shqiptare, për t'i nxitur ata që punojnë në arsim të marrin një diplomë Masteri profesional. Ai është organizuar për t'u përqendruar tek të nxënit dhe kërkimi, dhe të ofrojë qasje praktike dhe ndërvepruese, që ishte e pazakontë në tregun shqiptar të arsimit të lartë **[Fletëpalosje e programit të nivelit Master; A24; A29; A45; A47; A48]**. Programi i studimit përfshin praktikën profesionale të detyrueshme, që mund të përfshijë të punuarit për Grupin Nehemia Gateway, ose ndonjë organizatë jashtë grupit. Studentëve iu vihet në dispozicion një broshurë e qartë dhe gjithëpërfshirëse, që shpjegon objektivat dhe rezultatet e synuara të të nxënit, vlerësimin, rolet, përgjegjësitë dhe burimet e mbështetjes **[A47; M4; C5]**.
- 3.8 Siç u përmend më sipër, të dy programet e studimit janë përkufizuar si “programe të dyfishta”, që ndërthurin qasjet teorike me ato praktike, për të ndihmuar në përmbushjen e misionit dhe objektivave strategjike të institucionit dhe, më gjerë, të organizatës. Studentët, në të dy programet e studimit, shprehen pozitivisht për mundësitë e zhvillimit të praktikës profesionale, duke theksuar se përvojat kanë qenë të dobishme dhe se ndiheshin të përkrahur nga stafi i institucionit. Të dy grupet e vunë theksin te mundësitë për punësim të vazhdueshëm, ose të mundshëm. Studentët shqiptarë janë veçanërisht mirënjohës për mundësinë e të studiuarit dhe punuarit në gjuhën angleze **[M4]**. Alumni janë po aq pozitivë, duke thënë se stazhet u kanë mundësuar atyre të përfitojnë pozicione pune te partnerët e Grupit Nehemia Gateway jashtë Shqipërisë dhe, në rastin e programit të nivelit Master, për të konsoliduar karrierën e tyre **[M5]**. Punëdhënësit vendorë mendojnë se programet ndihmojnë në përmbushjen e nevojave socio-ekonomike të rajonit të Pogradecit dhe Korçës **[M5]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte i mendimit se programet e dyfishta të institucionit, të cilat integrojnë teorinë me praktikën, për të nxitur punësueshmërinë, janë një karakteristikë e **praktikës së mirë [A48]**.
- 3.9 Siç u përmend, kurrikula e institucionit është në përputhje me sistemin evropian të krediteve (ECTS), dhe kjo është pohuar në kuadër të akreditimit nga FIBAA, në vitin 2015 **[A29; A45; A48; A51]**. Janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të nxitur një kontekst ndërkombëtar të të nxënit. Studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, janë shumë pozitivë në lidhje me disponueshmërinë e stafit ndërkombëtar dhe mundësinë për të studiuar në gjuhën angleze. Studentët e huaj gjithashtu nxiten të vizitojnë shkollat verore të institucionit. Vihet re një angazhim për të nxitur shkëmbimin e studentëve, duke përfshirë ata që vijnë nga Shqipëria **[M1; C3; C4]**. Studentët kënaqen me udhëtimet studimore në Gjermani dhe në vende të tjera evropiane. Institucioni, gjithashtu është regjistruar në Programin Erasmus **[A30; M4; M5]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se hapat e ndryshëm, të ndërmarrë për të realizuar mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë, përbëjnë një karakteristikë të **praktikës së mirë**.
- 3.10 Siç përshkruhet në pikën 3.8, institucioni ofron programe të dyfishtë, të hartuar për të integruar teorinë dhe praktikën, me qëllim nxitjen e punësimit të studentëve. Si të tillë, të dy programet pasqyrojnë përkushtim ndaj punësimit të studentëve. Studentët theksuan se këshillimi jo formal i karrierës është gjithashtu i disponueshëm, por roli i trajnerëve dhe mentorëve në programet e studimit është më i rëndësishëm **[M4; A27; A49]**. Përpos këtyre, institucioni ndërmerr hapa për të punësuar të diplomuarit e tij në Shqipëri, ose në organizatat partnere jashtë shtetit **[M4]**. Zhvillohen anketimet për alumni, pas diplomimit, si për të krijuar lidhje të qëndrueshme, ashtu edhe për të reflektuar mbi efektivitetin e programeve të studimit **[A26 ; A27; A56; M1; M3; M5]**. Institucioni synon të monitorojë punësimin e studentëve. Kjo është më e lehtë për t'u realizuar, nëse studentët punojnë në një nga organizatat partnere të

Grupit Nehemia Gateway, për shembull në Ugandë, por që është më sfiduese për shqiptarët e diplomuar [M3; M5]. Si rrjedhojë, Institucioni synon ta forcojë monitorimin e të dhënave të punësimit.

## Gjetje

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- programet e dyfishta të institucionit, që integrojnë teorinë me praktikën, për të nxitur punësueshmërinë (pika 3.8 dhe 5.9; **Kapitulli I Standardi I.11, Kapitulli I Standardi III.9**)
- hapat e ndryshëm të ndërmarrë, për të mundësuar mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe përtej Evropës (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.10**).

### Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim që po ndërmerret.

## Gjykimi

**Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Institucioni ka dy fakultete, të cilët aktualisht ofrojnë dy programe akademike, konkretisht Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë ofron programin e nivelit Bachelor në Ekonomi dhe Biznes, ndërsa Fakulteti i Shkencave Humane ofron programin e nivelit Master në Leadership dhe Vlerësim Arsimit [A5]. Institucioni ka bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për një ndryshim strukturor: për të vepruar si Akademi dhe për të pasur vetëm një fakultet, konkretisht Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Biznesit, i ndarë në tre departamente [A1 fq. 56; M2]. Këto të fundit do të jenë: Departamenti i Menaxhimit, Departamenti i Leadershipit dhe Instituti i Kërkimit. Institucioni është në pritje të një përgjigje nga Ministria, dhe pas miratimit do të vijojë me ndryshimet ligjore [A1 fq. 56]. Institucioni ka mekanizma të përshtatshëm, për të siguruar organizimin dhe dokumentimin e efektshëm të programeve të studimit [A33; A49; A59; M3]. Struktura e përmbajtjes së programit është objekt diskutimi në nivel departamenti, duke qenë se është njësi bazë e zhvillimit të kurrikulës [C9]. Syllabuset dhe kurrikulat e programeve të studimit hartohen, për të arritur objektivat e përgjithshme të programit të studimit, të cilat janë të përcaktuara qartësisht në Statutin e institucionit dhe në Planin Strategjik [A10]. Të dy programet e ofruara nga institucioni, funksionojnë si “programe të dyfishta”, duke ndërthurur qasjen teorike dhe praktike, për të përmbushur misionin dhe objektivat strategjike të Institucionit. Studentët shprehën pikëpamje shumë pozitive për mundësitë e stazhit, duke theksuar se përvojat e fituara kanë qenë jashtëzakonisht të dobishme, dhe ndiheshin të mbështetur nga stafi i institucionit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e vlerëson faktin që institucioni ofron shumë mundësi stazhi për studentët, si një karakteristikë e praktikës së mirë [A51; M4]. Institucioni ofron infrastrukturë të përshtatshme, me objekte dhe pajisje të ndryshme [Turi i kampusit].
- 4.2 Të gjitha rregullat për provimet miratohen dhe iu bëhen studentëve të ditura [A1 fq. 57]. Rezultatet e vlerësimit bëhen të njohura në mënyrë të tillë, që të respektojnë parimet e konfidencialitetit dhe pritshmëritë [M4]. Institucioni mundëson sistemin intranet, dhe studentët njoftohen se notat e tyre përfundimtare janë të aksesueshme nëpërmjet këtij sistemi, dhe më pas ata mund të shkojnë te Zyra e Provimeve, për t'i marrë. [A54]. Studentët kanë të drejtë që të komunikojnë me pedagogët për çdo lloj sqarimi mbi performancën në provim dhe notat e tyre [M4; M6]. Studentët që përmbushin kërkesat e programit të tyre, institucioni i pajis me diplomë të miratuar nga vetë institucioni [M1; M2; M4]. Programi i studimit të nivelit Bachelor u akreditua nga agjencia e akreditimit FIBAA, më 26/02/2016, dhe nga APAAL-i, në vitin 2013. Programi i Masterit u akreditua nga agjencia gjermane e akreditimit FIBAA, më 27/11/2015 [A55].
- 4.3 Institucioni ka zhvilluar dhe po zbaton një Plan Vlerësimi, [A11] që përfshin krahasimin e kërkesave të programit me programe të tjera të ngjashme dhe rishikimin e përmbajtjes së kurrikulës [A49]. Përshkrimet e moduleve rishikohen çdo tre vite, ndërkohë që pikëpamjet e studentëve merren në konsideratë rregullisht, nëpërmjet anketimeve për programet e studimit [A1 fq. 58; A49]. Punëdhënësve iu kërkohet të marrin pjesë në anketime, në lidhje me performancën e studentëve gjatë stazhit, ku vlerësohen rezultatet e të nxëniet të studentëve [A50; A52; A56; A60]. Kurrikula rishikohet në Mbledhjet e Komisionit të Kurrikulës dhe në nivel fakulteti [A6]. Departamentet janë përgjegjëse për krahasimin e kurrikulës me programe të ngjashme nga institucione të arsimit të lartë dhe për raportimin e përvitshëm te Dekani i Fakultetit [B9; M3; M6].
- 4.4 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies është një ndër pikat kryesore ku

përqendrohet institucioni, dhe të gjitha mekanizmat për këtë përcaktohen në Planin e Vlerësimit të institucionit [A11]. Procesi i vlerësimit shqyrton treguesit e performancës së programeve dhe ka autonomi operacionale [A56]. I gjithë stafi akademik i nënshtrohet procesit të vlerësimit, që realizohet çdo vit. Stafi akademik vlerësohet në anë të një anketimi në internet, që përmban si pyetje të mbyllura, ashtu edhe të hapura [M3; M6]. Stafi akademik iu ofron studentëve mundësinë të plotësojnë formularin e vlerësimit në internet [M4]. Anketimi përbëhet nga këto elemente: vlerësimi i kompetencave didaktike të pedagogut; përpjekjet e studentëve, ecuria akademike dhe nxitja e interesit midis studentëve; kuadri i përgjithshëm i pedagogëve [A1 fq. 59]. Drejtori i Menaxhimit të Cilësisë në Institucion mbledh të dhëna për analizë të mëtejshme [A56]. Rezultatet nga anketimet i dërgohen Përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit [M3]. Ky është një proces i efektshëm dhe gjithëpërfshirës, që i përmbahet plotësisht standardeve.

- 4.5 Kërkimi zhvillohet kryesisht në mënyrë vetjake nga stafi akademik dhe nga studentët e nivelit Master. Institucioni nuk ofron programe doktore. Nuk ka politika kërkimi dhe niveli i kërkimit institucional është i ulët, përfshirë mungesën e një programi doktore, dhe si rrjedhojë vlerësuesit e konsiderojnë këtë si **dobësi** [A1 fq. 61; M2; M3]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që institucioni të rrisë vëmendjen në kërkimin shkencor, të zhvillojë dhe të zbatojë politikat e tij të kërkimit. Përfshirja e një axhende kërkimi është një ndër synimet afatgjata të institucionit, që do të zbatojë kërkesat ligjore për zhvillimin e saj [A1 fq. 61; A10]. Megjithatë, kërkimi në nivel Masteri kryhet në nivel shumë të mirë shkencor. Temat përzgjidhen me kujdes, në bazë të disponueshmërisë dhe fushës së ekspertizës së tyre [M3, M4, M6]. Diskutimi i temave për tezën e diplomës kryhet në nivel departamenti, që mbështet prioritetet e fushës së kërkimit. Studentët kanë dy mentorë të cilët mund të mbështeten kur është e nevojshme [B6; M3; M4].
- 4.6 Institucioni po bën hapa drejt procesit të ndërkombëtarizimit të Grupit Nehemia Gateway. Institucioni ka studentë, staf akademik dhe personel mbështetës, me shtetësi të ndryshme, shqiptare dhe të huaj, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë një si karakteristike të **praktikës së mirë** [M6; Dosjet e studentëve u vunë në dispozicion gjatë vizitës]. Struktura organizative ka pjesëtarë të stafit si shqiptarë, ashtu edhe të huaj. Përveç studentëve vendas, institucioni ka edhe studentë nga Meksika, Kuba, Gjermania, Tanzania, Sudani i Jugut dhe nga Uganda [A2; M4]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi se, megjithëse institucioni nuk po kryen ndërkombëtarizimin e kërkimeve shkencore, stafi dhe studentët ndërkombëtarë e ndihmojnë të rrisë ndërgjegjësimin dhe i ndihmon ata të kuptojnë nevojën për kërkim.
- 4.7 Kërkimi vetjak në nivel të stafit akademik ka nivel të mirë performance bazuar në kualifikimet dhe botimet e tyre [B7; M3]. Stafi akademik ka punuar në mënyrë intensive, për kërkimin vetjak dhe arritjet akademike [M6; Anketimi i pedagogëve]. Gjatë vizitës në Institucion, u vu në dispozicion një listë botimesh, që e mbështet këtë angazhim [C7]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, siç u shpjegua më sipër, i sugjeron institucionit të bashkërendojë përpjekjet dhe të bashkëpunojë për një politikë institucionale të kërkimit.

## Gjetje

### Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë.

- institucioni iu ofron studentëve shumë mundësi për stazh dhe i mbështetet ata gjatë këtij procesi (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1**)
- shumëllojshmëria e shtetësive, me studentë shqiptarë dhe të huaj, staf akademik dhe mbështetës, si shqiptar, ashtu edhe të huaj. (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.3**).

### Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Nuk ka politikë për kërkimin, dhe ka një nivel të ulët të kërkimeve institucionale, përfshirë mungesën e një programi doktorature. (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.2**).

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Institucioni duhet të përqendrohet më shumë në kërkimin shkencor dhe të zhvillojë e të zbatojë politikën e tij të kërkimit (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.2**).

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

## Gjykimi

**Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.**

## Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Përgjegjësitë për Studentët dhe Mbështetja e tyre, përcaktohen qartë në Statutin e institucionit [A6]. Procedura e pranimit është në përputhje me kërkesat ligjore të legjislacionit shqiptar për Institucionet e Arsimit të Lartë [A1 fq. 62]. Institucioni ofron vetëm dy programe studimi, [A5] siç përshkruhet më sipër. Procedura e regjistrimit shpjegohet qartë dhe publikohet në faqen e internetit të institucionit [<http://www.ng-university.org>]. Dokumentacioni i nevojshëm për pranim, konsideron si kërkesa minimale të pranimit: dokumentet e aplikimit dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit [A1 fq. 62]. Institucioni kërkon nivel B2 të gjuhës angleze (Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët) për të gjithë studentët e regjistruar; një intervistë ballë për ballë është pjesë e procesit të pranimit [<http://www.ng-university.org/study-programs/how-to-apply.html>]. Institucioni organizon vizita rekrutimi, gjatë të cilave stafi akademik dhe personeli administrativ, vizitojnë shkollat e mesme në rajon dhe prezantojnë programet e studimit që ofrojnë [M2]. Ata kanë në plan të marrin pjesë në panairin vjetor të studentëve, që organizon Ministria e Arsimit dhe Sportit në Tiranë [M2; M3]. Në fillim të çdo viti akademik, organizohet java e mirësearchjes, që përshpejton akomodimin e studentëve në institucion [A46; M4].
- 5.2 Komunikimi me studentët është shumë i mirë dhe lehtësohet nga numri relativisht i vogël i studentëve [A2; A30; A31; A1 fq. 65]. Raporti midis studentëve dhe stafit është përafërsisht 1 me 6 [A2; B9]. Gjatë javëve të para organizohen edhe takime informuese dhe këshilluese për studentët [A46; M4]. Çdo student dhe anëtar i stafit ka një adresë postare elektronike personale të brendshme, që ndihmon procesin e komunikimit [[name.surname@ng-university.org](mailto:name.surname@ng-university.org)., [name.surname@nehemiah-gateway.org](mailto:name.surname@nehemiah-gateway.org)]. Institucioni mban dosje personale për secilin student, dhe çdo dosje përmban: të dhëna personale nga procesi i aplikimit dhe pranimit; kontratën midis studentit dhe institucionit; dhe rezultatet e vlerësimit gjatë gjithë periudhës së studimit [A1 fq. 66; A59; M4]. Institucioni disponon mjete të ndryshme dhe qasje me shumë nivele për ndarjen e informacionit, që përfshin: adresën e emailit; akses në intranetin e Grupit të Nehemia Gateway dhe të institucionit; dhe kopjet e shtypura të botimeve [A28; A49].
- 5.3 Institucioni siguron procedura informimi dhe orientimi për studentët dhe palët e tjera të interesit [A1, fq. 66, A6]. Informimi dhe orientimi i studentëve është një proces i vazhdueshëm gjatë viteve të studimit. Të gjitha paketat informuese janë të postuara në faqen e internetit, ose në intranet, dhe në manualin e studentëve [A55; <http://www.ng-university.org>]. Studentëve iu ofrohet ndihmë, këshilla dhe shërbime orientimi, gjatë dhe pas përfundimit të studimeve të tyre [M4]. Sistemi i mentorimit funksionon shumë mirë brenda institucionit, sidomos për studentët që vijnë nga jashtë vendit [M4; M6]. Për këta studentë, institucioni ka një politikë mentorimi dhe udhëzimi, në ndihmë të përmbushjes së nevojave të tyre të përditshme [M4]. Studentët mund t'i kontaktojnë pedagogët e tyre gjatë orarit të punës, leksioneve dhe seminareve [Pyetësori për studentët fq. 6] Çdo studenti i caktohet një këshilltar akademik, me të cilin duhet të konsultohet të paktën një herë në tre muaj [M6]. Ky këshilltar akademik do të jetë edhe mentori i studentit gjatë praktikës profesionale dhe do të udhëheqë përgatitjen e tezës së kërkimit shkencor [C6].
- 5.4 Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara, ose për studentët që i përkasin kategorive të veçanta [A1 fq. 67; A47] Institucioni, si pjesë e Grupit Nehemia Shqipëri, për më shumë se 20 vjet ka zbatuar misionin për të ndihmuar njerëzit në nevojë [A6; 10]. Siç parashtrohet edhe në rregulloren dhe aktet e institucionit, ai përmbush të njëjtin mision, duke i mbështetur të gjithë njerëzit



pavarësisht prejardhjes, besimit apo kombësisë. Misioni i institucionit është “Të ndihmojmë njerëzit, të ndihmojnë veten” [A1 fq. 67].

- 5.5 Institucioni ka një bibliotekë me afërsisht 9,400 libra. Disponon literaturë shumëdisiplinore, të tillë si: libra; buletine; enciklopedi; harta muri; gazeta; albume dhe ndihmë me gjuhën ose terminologjinë [Turi i kampusit A1 fq. 67; M5]. Literatura e bibliotekës pasurohet nga buxheti vjetor për blerje, dhe nga burime të tjera, si donacionet [A57]. Ka edhe disa burime mësimore të tjera, në mënyrë elektronike, dhe Biblioteka e institucionit ka një partner tjetër, Bibliotekën Shtetërore të Bavarisë [Turi i kampusit]. Institucioni mundëson dhënien e literaturës dhe regjistrimin në internet, ku kërkohen disa të dhëna personale të studentëve përkatës, si emri, mbiemri dhe adresa e emailit. Biblioteka, orarin e punës e ka të shpallur në ambientet e institucionit, dhe zakonisht qëndron e hapur në oraret: 8: 00-13: 00 dhe 14: 00-19: 00 [A1 fq. 67; <http://www.nq-university.org/student-RVVvices/library.html>].
- 5.6 Institucioni ofron tutorim për studentët e ciklit të parë, nëpërmjet shërbimeve të administratës dhe Qendrës së Shërbimit të Studentëve [A6; A1 fq. 68; M4]. Alumni janë tashmë të punësuar nga Nehemia Gateway Shqipëri dhe institucioni ofron gjithashtu shërbime dhe mbështetje. Studentëve u ofrohet mbështetje që nga dita e parë në institucionin, falë Javës së Orientimit [A46; M4, M5]. Përpos procesit formal të tutorimit, komunikimi i përditshëm midis pedagogëve dhe studentëve ofron mundësi të mëtejshme, për të mbështetur dhe lehtësuar ecurinë e studentëve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë [M4; M6]. Institucioni ofron kurse të ndryshme në bazë të nevojave dhe vështirësive të identifikuara të studentëve, sidomos për studentët në kurset e gjuhës angleze ose gjermane dhe komunikimit ndërkulturor [M4]. Në Institucion, të gjitha lëndët zhvillohen në gjuhën angleze dhe disa prej këtyre kurseve jepen nga lektorë ndërkombëtarë; Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si një karakteristikë të praktikës së mirë [A49; M4]. Kjo është shumë pozitive për studentët shqiptarë, që kanë mundësinë të përjetojnë mënyrën ndërkombëtare të mësimdhënies dhe të të nxëniet, megjithëse është e rëndësishme dhe e dobishme edhe për studentët e huaj [A28].
- 5.7 Studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në nivelin institucional të institucionit [A6]. Ata marrin pjesë në Këshillin e Studentëve [A58], që është një organ i pavarur brenda Institucionit dhe që ndihmon në promovimin dhe mbështetjen e interesave të studentëve [B11]. Çdo program ka përfaqësuesin e tij brenda institucionit dhe gjithsej janë katër përfaqësues të studentëve [M4; M6]. Përfaqësuesit e studentëve janë nga të dy kurset, të nivelit Bachelor dhe nivelit Master, që marrin pjesë edhe në mbledhjet e Fakultetit [A1 fq. 69; M4].
- 5.8 Institucioni ka krijuar Qendrën e Shërbimit Studentor për të lehtësuar jetën studentore [A6; M4; C8]. Në fillim të çdo viti, organizohet një festë mirëseardhjeje, për t'i mirëpritur studentët e rinj dhe për t'i ndihmuar ata të njihen me ambientet e kampusit [M4; M5]. Qendra Studentore organizon aktivitete të ndryshme si: aktivitete sportive dhe sociale, udhëtime, gazetari, menaxhim konflikti, arte dhe kulturë, teknologji dhe inovacione, dhe konsultime [A34; 42; C8]. Duke qenë se institucioni akomodon edhe studentë të huaj, kjo ndihmon në shkëmbimin kulturor ndërmjet tyre, nëpërmjet organizimit të disa aktiviteteve [M4]. Bashkëpunimi i ndihmon ata të ndajnë traditat e tyre kulturore dhe të mësojnë si të respektojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin [M4]. Ndërtesa sociale dhe mjekësore, si pjesë e kampusit, siguron qendra të ndihmës së shpejtë, trajtim mjekësor dhe masazh për të gjithë stafin dhe studentët [Turi i kampusit].
- 5.9 Të dhënat e institucionit tregojnë përqindje shumë të lartë të punësimit të

studentëve, si të studentëve shqiptarë, ashtu edhe atyre të huaj. Institucioni ka disa marrëveshje me institucione të tjera, publike dhe private, për stazhin e studentëve dhe punësimin e tyre të mundshëm, në të ardhmen [A32]. Institucioni ofron mundësi punësimi për studentët e diplomuar, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si një karakteristikë të praktikës së mirë [A1, fq. 70; M5; C8]. Në bazë të të dhënave të institucionit, të gjithë studentët e parë të këtij institucioni u punësuan në Nehemia Gateway Shqipëri [A1 fq. 70]. Nehemia Gateway e konsideron veten një “inkubator biznesi” për bizneset e reja, dhe në këtë mënyrë ndihmon studentët e vet për të fituar përvojë pune ndërkombëtare në projektet e Grupit të Nehemia Gateway [A1 fq. 70]. Institucioni ka ndërmarrë gjithashtu studime të tregut për punësimin e të diplomuarve të tij [A53] dhe programet e studimit të dyfishtë, që integrojnë përgatitjen teorike dhe praktike, nëpërmjet stazhit, duke i ndihmuar studentët që të fitojnë më shumë aftësi dhe zotësi për punësimin e tyre në të ardhmen. Kjo është një karakteristikë e praktikës së mirë, e identifikuar në Fushën e Vlerësimit 4. [M4; A32; C2; C5]. Një strukturë alumni është gjithashtu pjesë e institucionit dhe mbështet studentët, nëpërmjet dhënies së këshillave dhe mentorimit [A60].

## Gjetje

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë.

- të gjitha kurset ofron në gjuhën angleze dhe disa prej kurseve zhvillohen nga lektorë ndërkombëtarë (pika 5.6; *Kapitulli I Standardi III.6*)
- institucioni ofron vende pune për studentët e diplomuar të tij (pika 5.9; *Kapitulli I Standardi III.9*).

### Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

## Gjykimi

**Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.**